



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly of Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në nenin 25 të Ligjit nr.08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, bazuar në Rregulloren nr.01/2025 për mekanizmin koordinues lokal për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, sipas nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, si dhe nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nr.-I-95, të dt.29.06.2018, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr. 02-020-01-16156-25, të dt.17.06.2025 nga Njësia Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2025, mori këtë:

V E N D I M


1. Themelohet mekanizmi lokal koordinues për Mbrojtje nga Dhuna në Famile, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Bazë Gjinore me këtë përbërje:

- 1.1. Xhafer Gashi, Kryetar
- 1.2. Brikena Pllana Mehami. DSHMS
- 1.3. Edita Çanta, Gjykata Themelore Prishtinë
- 1.4. Arlind Popaj, Prokuroria
- 1.5. Mema Mjeku, ZMNY-Prokuroria
- 1.6. Reijan Ibrahim, BIK-Obiliq
- 1.7. Mexhid Krasniqi QPS
- 1.8. Adlije Seta, Policija e Kosovës
- 1.9. Zana Asllani, Strehimorja-QMGF
- 1.10. Fatime Pllana, DKA
- 1.11. Vjollca Hoti, QKMF
- 1.12. Slavisa Adjancic, ZLK
- 1.13. Faton Jashari, Ndhima Juridike Falas A.N.J.F.
- 1.14. Emine Berisha, Zyra e punësimit
- 1.15. Ganimete Aliu, Njësia antidiskr. dhe barazi gjinore
- 1.16. Zelushe Kelmendi, Qendra Rinore

2. Mekanizmi Koordinues Lokal koordinon aktivitetet për parandalimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të të gjitha formave të dhunës pa diskriminim në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë bazë tjetër me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.
3. Ky Mekanizëm lokal Koordinues do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me Ligjin nr.08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, në pajtim me aktin nenligjor të propozuar nga Ministria e drejtesisë në bashkëpunim me MAPL-ne, dhe të miratuar nga Qeveria.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe Shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet:

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesuesit
- MAPL-së
- Njësisë antidiskriminimi dhe barazi gjinore
- Anëtarëve të KK
- Arkivit

Kryesuese e Kuvendit,

Vlora Mjekiqi Kabashi

